




Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIC OF KOSOVO  
KUVENDI KOMUNAL ASSEMBLY OF MUNICIPALITY SKUPŠTINA OPŠTINE  
SKENDERAJ

Nr. \_\_\_\_\_  
No. 07-110/09-0017276/26  
Data: \_\_\_\_\_  
Data: 12-05-2026



Komuna Skenderaj  
Opština Skenderaj  
Municipality of Skenderaj

**PROCESVERBAL I KONSULTIMIT  
PUBLIK PËR DRAFT -  
RREGULLOREN  
PËR INSTITUCIONET  
EDUKATIVO -ARSIMORE NË  
KOMUNËN E SKENDERAJT**

Duke duke u bazuar në Ligjin numër 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Statutin e Komunës së Skenderajt Nr.110-385 i datës 03.12.2008 dhe Nenit 30 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të Hapur në Komunë, Drejtoria e Arsimit bën njoftimin për: **Konsultim publik për Draft-Rregulloren institucionet edukativo – arsimore në komunën e Skenderajt.**

Më datën 24.03.2023 është emëruar komisioni për hartimin e rregullorës i cili në bashkëpunim me zyrën ligjore ka filluar hartimin e draftit fillestar të “Rregullorës për institucionet edukativo – arsimore në komunën e Skenderajt.

Me datën 15.04.2026, është publikuar njoftimi për mbajtjen e konsultimit publik për **Draft-Rregulloren institucionet edukativo – arsimore në komunën e Skenderajt**. Njoftimi është publikuar në uebfaqen zyrtare të Komunës dhe Platformën e Konsultimeve Publike.

Plani u publikua në këtë link në faqen zyrtare:

<https://skenderaj.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/04/RREGULLORE-PER-INSTITUCIONET-EDUKATIVE-ARSIMORE-TE-KOMUNES-se-Skenderajt15-1.docx>

Në Platformën e Konsultimeve Publike:

<https://skenderaj.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/04/RREGULLORE-PER-INSTITUCIONET-EDUKATIVE-ARSIMORE-TE-KOMUNES-se-Skenderajt15-1.docx>

## **KONSULTIMI PUBLIK ME QYTETARË**

Me datë: 15.04.2026 mbahet konsultimi publik në sallën e Kuvendit Komunal. Në këtë diskutim publik morën pjesë mësuesit dhe edukatorët nga shkollat tona si dhe përfaqësues nga shoqëria civile.

Dëshmi janë listat e nënshkrimeve.

Lajmin për mbajtjen e konsultimit mund të gjeni të publikuar në vegëzën: <https://skenderaj.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/04/Njoftim-DKA.pdf>

Konsultimi publik filloi në orën 13:00 në sallën e Kuvendit Komunal.

Konsultimin e shpalli të hapur drejtori i Arsimit z.Kastriot Duraku, i cili në pika të shkurtra prezantoi përmbajtjen e Draft – Rregullores për institucionet edukativo – arsimore në komunën e Skenderajt, e cila ka për qëllim të përcaktojë të drejtat dhe obligimet, veprimet e ndaluara, vijueshmërinë në mësim, masat dhe procedurat disiplinore dhe zbatimin e tyre ndaj nxënësve, mësimeve dhe personelit tjetër në shkollë (drejtori, zëvendësdrejtori, mësimeve/mësuesi/ja, pedagogu/psikologu, sekretari ose administratori, koordinatori i cilësisë, këshilltari i karrierës, bibliotekari dhe personeli tekniko-shërbyes).



**Kastriot Duraku, drejtori i Arsimit:** Fillimisht i përshëndeti dhe falënderoi të gjithë të pranishmit për pjesëmarrjen në këtë diskutim publik lidhur me draft- Rregulloren për institucionet edukativo – arsimore në komunën e Skenderajt. Sipas tij, kjo rregullore synon ngritje të cilësisë në realizimin e procesit edukativo-arsimor, shkallë të lartë demokratizimi brenda sistemit tonë arsimor, frymë pozitive konform reformave arsimore me qëllim që në

shkollat tona nxënësit të jenë në qendër të vëmendjes si në mësim ashtu edhe në aktivitete jashtëmësimore.

Pasi të përfundojnë të gjitha procedurat e parapara me udhëzimin për standardet minimale të konsultimeve publike, draft-plani do të shkojë edhe në Kuvend, i cili sapo ta miratojë, do të bëhet i plotfuqishëm.



Në këtë Rregullore përcaktohen qartë rregullat e organizimit të punës, të drejtat dhe detyrat e organeve vendimmarrëse, të personelit udhëheqës, të shërbimeve profesionale, të mësimdhënësve, të nxënësve, të personelit tekniko-shërbyes në institucionet parashkollore, fillore, të mesme të ulëta dhe të mesme të larta në Komunën e Skenderajt. Gjithashtu, në këtë rregullore përcaktohet edhe regjistrimi i nxënësve në klasën e parë, fëmijëve në klasën përgatitore dhe në institucionet parashkollore, duke u bazuar edhe në UA në fuqi.

Kryesuesja e komisionit e shpalli të hapur diskutimin publik, në të cilin shumë drejtor shkollash dhe mësimdhënës shprehen sugjerimet e tyre, kështu duke dhënë sugjerime të ndryshme rreth rregullores.

Në këtë diskutim publik, prezent ishin edhe zyrtarët e Drejtorisë së Arsimit-Skenderaj, të cilët mbajtën procesverbalin e diskutimit dhe morën çdo shënim që u diskutua. Më pas të gjitha këto janë analizuar edhe me zyrën ligjore të komunës dhe disa nga sugjerimet të cilat ishin në përputhje me ligjet në fuqi u inkorporuan në rregullore.



Pjesë nga diskutimi me qytetarë:

**Fjolla Aliu – kryesuese e komisionit :** Nëse keni ndonjë sugjerim rreth Rregullores për institucionet edukativo – arsimore në komunën e Skenderajt, ju lutemi shprehuni me radhë?

**Besart Rrecaj – zëvendës drejtor shkolle:** Sugjeroj që neni 60, ndërrimi i paralelës të ndryshohet të masat edukative disiplinore për nxënës!

**Ajet Ajeti – drejtor shkolle:** Propozoj që kodi i veshjes të jetë i njëjtë për të gjithë mësimdhënësit?

**Arizona Musa – drejtoreshë shkolle:** Propozoj që të vendoset si pike e veçantë apo e përmendur kontrata dhe marrëveshja me institucion prindër, për vijimin e fëmijëve në institucion?

**Agron Istogu – drejtor shkolle:** Propozoj që të theksohet me nen të veçant ndalimi i përdorimit të telefonave nga nxënësit në ambientin e shkollës.

**Kastriot Duraku – drejtori i DKA-së :** A ka dikush ndonjë koment tjetër rreth këtij Plani?

Nëse jo, ju faleminderit për pjesëmarrjen tuaj!

Konsultimi përfundoi në orën: 13:50

Anëtar i komisionit  
Visar Shabani



Lista e nënshkrimeve të qytëtarëve pjesmarrës në konsultim publik lidhur me hartimin e rregullorës për institucione edukativo - arsimore

Nr	Emri Mbiemri	Nënshkrimi
1	ANTON ISTOGU	Anton
2	Armond Hoti	Armond
3	Ardi JAKUPI	Ardi
4	Shkëlqim Jodri - Morina	Shkëlqim
5	Halil Shabani	Halil
6	Visar Shabani	Visar
7	Agren Ferizi	Agren
8	Dalip Ymeri	Dalip
9	Datmir Hoti	Datmir
10	Arizona Musa-Vllasa	Arizona
11	Enver Malaj	Enver
12	Antigona Maligi	Antigona
13	Von Vajta	Von
14	Albion Ajeti	Albion
15	Besjona Gashi	Besjona
16	Andeta Xani	Andeta
17	Arben Zabeli	Arben
18	Bekim Jafaj	Bekim
19	Besnik Xani	Besnik
20	Faik Gecaj	Faik
21	Semir Fazli	Semir
22	Sheban Lushitaku	Sheban
23	Ismael Malaj	Ismael
24	Mahir Thaçi	Mahir
25	Art Ajeti	Art
26	ZEQIR KADRIU	Zeqir
27	Lufti Hajdari	Lufti
28	Mebrat Gashi	Mebrat
29	Afrim Gushitaku	Afrim
30	FATMIR HOTI	Fatmir
31	HALIT KABAQHI	Halit
32	ALI NHRA	Ali
33	BESNIK MZIU	Besnik
34	SHEHRIJE RAMA	Shehrije
35		
36		
37		
38		
39		
40		

Datë 15.04.2026